

Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore



 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	2 nga 42

TABELA E PËRMBAJTJES


Fjalorthi i termave	4
Përkufizimi i zonave “tokësore”, “jotokësore”, “bregdetare” dhe “detare”	5
Lista e akronimeve dhe shkurtesave.....	6
1 Hyrje	8
1.1 Objektivat	8
1.2 Fushëveprimi.....	8
1.3 Përgjegjësitë.....	9
2 Shmangia dhe lehtësimi i ndikimit tokësor	13
2.1 Studimet e para-ndërtimit dhe përshtatjet e projektimit	13
2.2 Monitorimi arkeologjik i ndërtimit	14
2.3 Procedura e Gjetjeve të Rastësishme	14
2.3.1 Kuadri i pajtueshmërisë	14
2.3.2 Procedura e Gjetjeve të Rastësishme.....	15
2.3.3 Raportimi i Gjetjeve të Rastësishme	16
2.3.4 Dokumentimi i Gjetjeve të Rastësishme	17
2.3.5 Gjetjet që kërkojnë njoftimin e Autoriteteve Civile	17
2.4 Mbrojtja e vendndodhjeve të njohura të trashëgimisë kulturore	18
2.4.1 Masat e përgjithshme të mbrojtjes	18
2.4.2 Mbrojtja nga dridhjet	18
2.4.3 Mbrojtja nga pluhuri dhe format e tjera të ndotjes së gurëve	18
2.4.4 Mbrojtja nga ndikimet negative estetike	19
2.4.5 Përdorimi nga komuniteti i vendeve të trashëgimisë kulturore	19
3 Shmangia dhe lehtësimi i ndikimit jotokësor	20
3.1 Studimet e para-ndërtimit dhe përshtatjet e projektimit	20
3.1.1 Studimet bregdetare të para-ndërtimit dhe përshtatjet e projektimit.....	20
3.1.2 Studimet detare të para-ndërtimit dhe përshtatjet e projektimit.....	20
3.1.3 Monitorimi arkeologjik i ndërtimit.....	20
3.2 Procedura e Gjetjeve të Rastësishme	21
3.2.1 Procedura për Gjetjet e Rastësishme Bregdetare.....	21
3.2.2 Procedura për Gjetjet e Rastësishme Detare.....	21
3.3 Mbrojtja e vendndodhjeve të njohura të trashëgimisë kulturore	21

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	3 nga 42

3.3.1	Masat e përgjithshme të mbrojtjes së vendndodhjeve të njohura të trashëgimisë kulturore bregdetare	21
3.3.2	Masat e përgjithshme të mbrojtjes së vendndodhjeve të njohura të trashëgimisë kulturore detare	21
3.3.3	Mbrojtja bregdetare nga ndikimet negative estetike	22
3.4	Përdorimi i vendndodhjeve të trashëgimisë kulturore nga komuniteti.....	22
4	Kontraktori Arkeologjik - Vështrim i përgjithshëm i projektit, fushëveprimi dhe udhëzimi	23
4.1.1	Faza 1: Rishikimi i të dhënave ekzistuese	23
4.1.2	Faza 2: Studime të zgjeruara dhe të thelluara	23
4.1.3	Faza 3: Gërmimet e para-ndërtimit	24
4.1.4	Faza 4: Gjetjet e Rastësishme gjatë ndërtimit	24
4.1.5	Faza 5: Raportimi.....	24
4.2	Vështrim i përgjithshëm i projektit, fushëveprimi dhe udhëzimi i Kontraktorit Arkeologjik Jotokësor	25
4.2.1	Faza 1: Rishikimi i të dhënave ekzistuese	25
4.2.2	Faza 2: Studime të zgjeruara dhe të thelluara	25
4.2.2.1	Zonat bregdetare	25
4.2.2.2	Zonat detare	25
4.2.3	Faza 3: Gërmimet e para-ndërtimit	25
4.2.4	Faza 4: Gjetjet e Rastësishme gjatë ndërtimit	25
4.2.5	Faza 5: Raportimi.....	25
5	Monitorimi dhe inspektimi	26
6	Trajnimi	26
7	Dokumentet përkatëse	26
	Shtojca 1 Angazhimet PËr TrashëgimiNë Kulturore Nga VNMS e Projektit.....	27


LISTA E TABELAVE

Tabela A-1 Angazhimet e trashëgimisë kulturore për vendndodhjen specifike *	27
Tabela A-2 Shpjegimi i angazhimeve të trashëgimisë kulturore.	31

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	4 nga 42

Fjalorthi i termave

Kontraktori arkeologjik	Kontraktori Arkeologjik është organizata e kontraktuar që të jetë përgjegjëse për një varg përgjegjësish të trashëgimisë kulturore. Kontraktori arkeologjik kontraktohet nga KOMPANIA
Pika e Kufirit Gjeografik të Projektit në Shqipëri	Vendi i parë i saldimit të thatë i tubacionit në Shqipëri (d.m.th., saldimi i thatë më afër detit)
KOMPANIA	Trans Adriatic Pipeline AG
KONTRAKTORI	Kontraktorët inxhinierikë, të prokurimit dhe ndërtimit (IPN) dhe nën-kontraktorët e tyre
Gjetjet e rastësishme	Objekte, veçori ose vende të mundshme të trashëgimisë kulturore (ose paleontologjike), që janë identifikuar jashtë ose pas një studimi zyrtar të vendit, normalisht si rezultat i menaxhimit të ndërtimit.
Zonat bregdetare	Zonat që ndodhen ndërmjet Pikës së Kufirit Gjeografik të projektit në Shqipëri dhe Mesores së Ujërave të Larta të Pranverës (MULP)
Ndikimi mbi trashëgiminë kulturore	Një ndryshim në trashëgiminë kulturore (në këtë kontekst “trashëgimia kulturore” i referohet çdo elementi të prekshëm (p.sh. objekte, artefakte, struktura, hapësira) ose të paprekshëm, që kanë vlerë ose rëndësi për kulturën, historinë dhe/ose identitetin e popullit), që ka ndodhur si rezultat i aktiviteteve të projektit. Ndikimet mund të konsiderohen të jenë pozitive ose negative.
Ndikimi mjedisor	Një ndryshim në mjedis (në këtë kontekst “mjedisi” i referohet çdo aspekti të mjedisit fizik natyror ose gjysmë-natyror (ajri, uji, toka etj.) që rezulton nga aktivitetet e Projektit. Ndikimet mund të konsiderohen të jenë pozitive ose negative.
Trashëgimia Kulturore Jomateriale	“Praktikat, paraqitjet, shprehjet, njohuritë, aftësitë - si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore të lidhura me to - të cilat komunitetet, grupet dhe, në disa raste, individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore (Konventa e vitit 2003 për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale). Për sa i përket Projektit, janë instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore përkatëse, që mund të preken.
Zonat detare	Zonat që ndodhen ndërmjet Mesores së Ujërave të Larta të Pranverës (MULP) dhe vijës mesore Shqipëri-Itali
Vija Mesore	Një kufi territorial detar i miratuar, që ndan Zonën(zonat) Ekonomike Ekskluzive (ZEE) të 2 a më shumë shteteve
Mesorja e Ujërave të Larta të Pranverës	Mesorja mesatare e niveleve më të larta që arrin baticë e pranverës në dy ujëra të larta të njëpasnjëshme gjatë këtyre periudhave prej 24 orësh kur shtrirja e baticës është në pikën më të lartë, të përfutur gjatë një periudhe kohore (përgjithësisht rreth 19 vjet). MULP konsiderohet pika në këtë projekt që përcakton caqet ndërmjet zonave detare dhe bregdetare, të cilat të dyja merren në konsideratë në PKK detare
Zonat Detare	Zonat që ndodhen ndërmjet Pikës së Kufirit Gjeografik të Projektit në Shqipëri dhe vijës mesore Shqipëri-Itali. Përfshin zonat bregdetare dhe detare.

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	5 nga 42

Projekti

Plani i propozuar i gazsjellësit për të sjellë gaz natyror nga rajoni Kaspik në Europën Perëndimore dhe atë Juglindore (TAP).

Ndikimi social-ekonomik

Një ndryshim në mjedisin ekzistues social-ekonomik (në këtë kontekst “mjedisi social-ekonomik” i referohet ndërthurjes së të gjithë faktorëve ekzistues social-ekonomikë), që ka ndodhur si rezultat i aktiviteteve të Projektit. Disa faktorë mund të përfshijnë aspekte të tilla si ato demografike, të shëndetit dhe të mirëqenies etj., dhe mund t’u referohen individëve, grupeve ose komuniteteve më të gjera të njerëzve. Faktorët ekonomikë mund të përfshijnë aspekte të tilla si punësimin, financat, jetesën etj. Një ndikim mund të konsiderohet të jetë pozitiv ose negativ.


Përkufizimi i zonave “tokësore”, “jotokësore”, “bregdetare” dhe “detare”

PMTK zbatohet në mënyrë specifike në punën për trashëgiminë kulturore si në zonat tokësore ashtu dhe në ato jotokësore, që mund të ndikohen nga Projekti në Shqipëri dhe është pjesë e menaxhimit të sistemit MSTK për projektin.

Zona “tokësore” quhen të gjitha zonat që ndodhen ndërmjet PK 0 [tokësore] dhe Pikës së Kufirit Gjeografik të projektit të Shqipërisë (d.m.th., vendit të saldimit të parë të thatë). Për informacion të mëtejshëm mbi vendndodhjen e Pikës së Kufirit Gjeografik të projektit, shih Kufijtë Tokësorë të Projektit të TAP - dokumenti i Pjesëve Tokësore (CPL00-ENT-100-F-DFO-0002).


Zonat “jotokësore” përfshijnë si zonat “bregdetare ashtu dhe ato “detare”, që përcaktohen si më poshtë:

- Zona “bregdetare” quhen të gjitha zonat që ndodhen ndërmjet Pikës së Kufirit Gjeografik të projektit në Shqipëri dhe Mesores së Ujërave të Larta të Pranverës (MULP).
- Zona “detare” quhen të gjitha zonat që ndodhen ndërmjet MULP-së dhe vijës mesore Shqipëri-Itali. Zonat “jotokësore” përfshijnë si zonat detare ashtu dhe ato bregdetare, dhe prandaj përfshijnë të gjitha zonat që ndodhen ndërmjet Pikës së Kufirit Gjeografik të projektit në Shqipëri dhe vijës mesore Shqipëri-Itali.


 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	6 nga 42

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

SMUPA	Sa më ulët që të jetë praktikisht e arsyeshme
ZeN	Zona e Ndikimit të korridorit të ndërtimit (Detare)
ASHA	Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
PKK	Planet e Kontrollit të Kontraktorit
TK	Vendet e Trashëgimisë Kulturore, veçoritë ose asetet
KTK	Këshilltari i Trashëgimisë Kulturore (KOMPANIA)
KooTK	Koordinatori i Trashëgimisë Kulturore (KooTK i KOMPANISË)
ETK	Eksperti i Trashëgimisë Kulturore (KOMPANIA)
MTK	Monitori i Trashëgimisë Kulturore (KONTRAKTORI)
PMTK	Planet për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore
PNK	Punonjësi i Ndërlidhjes me Komunitetin
SHEA	Shoqata Evropiane e Arkeologjisë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KP-të e BERZH	Kërkesat e Performancës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ZEE	Zona Ekonomike Ekskluzive (zonat jashtë territorit qendror që shtrihen në një maksimum prej 200 miljesh detare përtej ujërave territoriale)
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor ose Social
PIMS	Plani i Implementimit Mjedisor dhe Social
DMMS	Dokumenti i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
SMMS	Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
KFB	Kablo me Fibra Optike
VNDNJ	Vlerësimi i Ndikimit mbi të Drejtat e Njeriut
liA	Instituti i Arkeologëve, një organizatë në MB
PK	Pikat Kilometrike që kanë të bëjnë me rrugën e gazsjellësit sipas rastit bazë të përshkruar në VNMS, (mundet që vendndodhja të ndryshojë për shkak të ndryshimit të rrugës)
Pikat Kilometrike [tokësore]	Pikat Kilometrike që kanë të bëjnë me rrugën e gazsjellësit tokësor në Shqipëri sipas rastit bazë të përshkruar në VNMS. “Tokësor” përfshi vendndodhjet në tokë dhe ato bregdetare. Vendndodhjet detare për rrugën e gazsjellësit në Shqipëri janë përfshirë nën një grup tjetër të Pikave Kilometrike. (mundet që vendndodhja të ndryshojë për shkak të devijimit të rrugës)
MeK	Ministria e Kulturës

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	7 nga 42

TAP Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP)
 TAP AG Kompania e përbashkët e Gazsjellësit Trans Adriatik
 MPSH Municionet e Pashpërthyerë
 SSHH Skema e Shkruar e Hetimit

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	8 nga 42

1 Hyrje

PMTK identifikon angazhimet e bëra në VNMS-në e Shqipërisë në lidhje me menaxhimin e trashëgimisë kulturore tokësore dhe jotokësore gjatë fazës së ndërtimit dhe vënies në punë të Projektit në Shqipëri dhe përshkruan përgjegjësitë e veprimet e KOMPANISË për sa i përket përmbushjes së këtyre angazhimeve. PMTK është një pjesë e Sistemit të Menaxhimit të MSTK - grupi i dokumenteve të menaxhimit të krijuara nga Kompania për të përshkruar masat që do të përdoren për të adresuar probleme të ndryshme që kanë të bëjnë me mjedisin, shëndetin e sigurinë, trashëgiminë sociale dhe kulturore.

Kur përshkruhet një angazhim specifik nga Regjistri i Angazhimeve në Shqipëri në këtë dokument, ai pasohet nga numri i tij i referencës siç është përcaktuar në Regjistrin e Angazhimeve të Projektit për Shqipërinë (p.sh. AL0012). Kërkesat shtesë janë përfshirë brenda këtij PMTK kur gjykohen se ato pranohen ndërkombëtarisht ose janë praktikë më të mira. Këto kërkesa shtesë nuk pasohen nga një numër reference.

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (CAL00-PMT-601-Y-TTM-0006) jep një shpjegim se si duhet të përdoret ky PMTK në lidhje me çdo dokument tjetër përkatës të Projektit.


1.1 Objektivat

Ky PMTK është përgatitur që të përcaktojë shmangien, minimizimin dhe masat e nevojshme të lehtësimit për të siguruar që ndikimet negative mbi trashëgiminë kulturore tokësore e jotokësore si rezultat i aktiviteteve të projektit të parandalohen ose, kur kjo nuk është e mundur, të pakësohen në një nivel sa më të ulët që të jetë praktikisht e arsyeshme (SMUPA¹) gjatë fazës së ndërtimit të pjesëve tokësore dhe jotokësore të gazsjellësit TAP në Shqipëri. Objektivat e këtij PMTK janë të garantohet që puna në lidhje me menaxhimin e trashëgimisë kulturore tokësore e jotokësore të jetë në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi, praktikë më të mira ndërkombëtare dhe të gjitha Kërkesat e Performancës të BERZH-it dhe IFC-së, angazhimet e bëra në VNMS-në për Shqipërinë, politikën e KOMPANISË për të shmangur të gjitha dëmtimet e mundshme ndaj burimeve kulturore (AL0450).

1.2 Fushëveprimi

PMTK përcakton planet dhe procedurat që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore tokësore e jotokësore, që KOMPANIA do të implementojë kur është e përshtatshme gjatë ndërtimit, duke përfshirë hidrotestim dhe vënien në punë.

¹Që një rrezik (ose ndikim) të jetë SMUPA, duhet të jetë e mundur të demonstronhet që kostoja e përfshirë në pakësimin e rrezikut/ndikimit të mëtejshëm do të jetë në shpërpjestim të madh me dobinë e përfutur. Parimi i SMUPA rrjedh nga fakti se mund të shpenzohen kohë, përpjekje dhe para të pafundme në përpjekjen për të reduktuar një rrezik/ndikim në zero. Nuk duhet kuptuar thjesht si një masë sasiore e përfitimit ndaj dëmit. Është më shumë një praktikë e mirë e zakonit të gjykitimit të baraspeshës së rrezikut dhe përfitimit nga shoqëria.

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	9 nga 42

Fushëveprimi i këtij PMTK përfshin:

- masat për shmangien, minimizimin dhe lehtësimin e ndikimit (përfshi studimet e para-ndërtimit, monitorimin e ndërtimit, procedurat e gjetjeve të rastësishme dhe mbrojtjen e vendndodhjeve të njohura dhe të panjohura të trashëgimisë kulturore tokësore e jotokësore)
- një vështrim të përgjithshëm arkeologjik të projektit.
- ngritjen e strukturës organizative për menaxhimin e burimeve kulturore.

Fushëveprimi i këtij PMTK përqendrohet në tri kategori të përgjithshme të trashëgimisë kulturore: vendndodhjet arkeologjike, monumentet dhe vendndodhjet me vlerë jomateriale të trashëgimisë kulturore (TKJ).

Kërkesat për monitorimin dhe inspektimin që kanë të bëjnë me këtë plan jepen me hollësi në Planin e Sigurimit të Pajtuëshmërisë për çështjet Mjedisore dhe Sociale (CAL00-PMT-601-Y-TTM-0005).

Ky PMTK zbatohet për të gjitha zonat tokësore dhe jotokësore që mund të ndikohen nga faza e ndërtimit të Projektit. Zonat tokësore përfshijnë, (por nuk kufizohen me), korridoret e punës, vendet e ndërtimit të stacioneve të kompresorëve, vendet e ndërtimit të stacioneve të valvulave të bllokimit, rrugët e aksesit/udhët e paasfaltuara, të gjitha rajonet për materialet e përkohshme dhe magazinimin e mbetjeve, kampet dhe kantieret e tubacioneve.


Zonat jotokësore që mund të preken nga faza e ndërtimit të Projektit përfshijnë si zonat bregdetare ashtu dhe ato detare. Për një përkufizim të mëtejshëm se çfarë quhet zonë “jotokësore”, “detare” ose “bregdetare” dhe kufijtë e tyre përkatës, shih Fjalorthin e Termave në këtë dokument.

Zonat detare përfshijnë, por nuk kufizohen me, pjesët e takimit me tokën, kanalën e gazsjellësit dhe zonën ngjitur me të, zonën që nevojitet për të shtruar kabllon me fibra optike (KFO), si dhe ujërat territoriale të Shqipërisë dhe Zonën Ekonomike Ekskluzive (ZEE) (për sa i përket shtrirjes së mundshme të çdo ndikimi detar si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit të Projektit në det). Zonat bregdetare përfshijnë, por nuk kufizohen me, pjesët e takimit me tokën, rripat e punimeve, rrugët (përfshi rrugët e aksesit, rrugët e paasfaltuara dhe rrugët publike), vendet për nxjerrjen e agregateve, vendet për hedhjen e sendeve të prishura, impiantet e betonit, të gjitha zonat për magazinimin e përkohshëm të materialeve dhe mbetjeve, kampet, kantieret e tubacioneve dhe zonat e mirëmbajtjes.

KOMPANIA duhet të ketë parasysh se, atje ku aktivitetet detare bëhen në tokë (p.sh. kantieret për magazinimin e tubacioneve në tokë dhe transporti me automjete i furnizimeve/personelit), do të zbatohen kërkesat e specifikuar në pjesën për shmangien dhe lehtësimin e ndikimit bregdetar dhe tokësor të këtij PMTK.

1.3 Përgjegjësitë

Përgjegjësia parësore e KOMPANISË në lidhje me trashëgiminë kulturore është zbatimi i kërkesave të këtij SMMS nëpërmjet sigurimit të pajtuëshmërisë dhe monitorimit të Kontraktorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në zbatimin e këtij PMTK-je. Hollësitë e kërkesave të sigurimit të pajtuëshmërisë janë përshkruar në Planin e Sigurimit të Pajtuëshmërisë për çështjet Mjedisore dhe Sociale CAL00-PMT-601-Y-TTM-0005). Kërkesat e KONTRAKTORIT janë përshkruar në PKK e Trashëgimisë Kulturore Tokësore e Jotokësore (AAL00-PMT-601-Y-TTM-0001 dhe AAL00-RSK-601-Y-TTM-0030). Si pjesë e Planit për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore (PMTK) të KOMPANISË, të gjitha veprimet e identifikuar në Shtojcën 1 do të shqyrtohen dhe do të miratohen me autoritetet

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	10 nga 42

kombëtare. Çdo ndryshim në hollësitë e përshkruara në Shtojcën 1, që identifikohen si pjesë e diskutimeve me autoritetet kombëtare, do t'i jepen KONTRAKTORIT.

KOMPANIA do të jetë përgjegjëse për të garantuar që të gjitha aktivitetet, të gjitha operacionet, pajisjet dhe makineritë në terren të jenë në pajtim me:


- legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi
- standardet dhe politikat e huadhënësve ndërkombëtarë
- kërkesat specifike brenda VNMS në Shqipëri dhe HRIA në Shqipëri.
- angazhimet e renditura në Regjistrin e Angazhimeve në Shqipëri.
- kërkesat e këtij dokumenti.

Çka u përmend më sipër zbatohet si për aktivitetet nën kontrollin e drejtpërdrejtë të KOMPANISË (d.m.th. aktivitetet e kryera vetëm nga KOMPANIA), ashtu dhe për ato nën kontrollin e saj jo të drejtpërdrejtë (d.m.th., aktivitetet e kryera nga KONTRAKTORI në emër të KOMPANISË). Sigurimi i pajtueshmërisë për aktivitetet nën kontrollin jo të drejtpërdrejtë të KOMPANISË do të arrihet nëpërmjet monitorimit të pajtueshmërisë.

KOMPANIA do të jetë përgjegjëse për çdo ndikim negativ mjedisor, social-ekonomik dhe mbi trashëgiminë kulturore, që vjen nga aktivitetet dhe operacionet e projektit nën kontrollin e saj të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, dhe për marrjen e çdo mase të nevojshme për t'i shmangur, minimizuar ose, nëse nuk është e mundur, për t'i lehtësuar ato. KOMPANIA do të jetë përgjegjëse gjithashtu për reagimin e menjëhershëm ndaj ngjarjeve aksidentale që shkaktohen nga aktivitetet e saj dhe për minimizimin dhe/ose lehtësimin sa më shumë që të jetë e mundur të çdo ndikimi negativ mjedisor, social-ekonomik dhe mbi trashëgiminë kulturore, që vjen si pasojë e aktiviteteve të saj.

KOMPANIA do t'i përmbushë këto përgjegjësi:

- duke kërkuar që KONTRAKTORI të hartojë PIMS për Trashëgiminë Kulturore Tokësore dhe Jotokësore, që përshkruajnë se si do t'i implementojë kërkesat e përshkruara në PKK e Trashëgimisë Kulturore Tokësore dhe Jotokësore (AAL00-PMT-601-Y-TTM-0001, AAL00-RSK-601-Y-TTM-0030), dhe t'i rishikojë këto PIMS përpara se t'i pranojë
- duke ua komunikuar përmbajtjen e këtij PMTK punonjësve të KOMPANISË dhe duke i trajnuar ata për të siguruar që të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me menaxhimin e trashëgimisë kulturore tokësore dhe jotokësore dhe raportimin e reagimin ndaj incidenteve.
- duke siguruar që të mobilizohen burime të përshtatshme për menaxhimin e trashëgimisë kulturore tokësore dhe jotokësore, duke përfshirë informacionin e dhënë nga çdo burim i specializuar, i nevojshëm për të siguruar planifikimin e efektshëm dhe implementim në kohë të masave
- duke siguruar pajtueshmëri nga punonjësit e KOMPANISË (përfshirë punonjësit e KONTRAKTORIT, shih më poshtë) me procedurat e përcaktuara në këtë PMTK
- duke siguruar pajtueshmëri nga punonjësit e KONTRAKTORIT me procedurat e përcaktuara në PIMS e Trashëgimisë Kulturore Tokësore dhe Jotokësore (nëpërmjet monitorimit të pajtueshmërisë)

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	11 nga 42


- duke vënë në jetë monitorimin e efektshëm të masave për menaxhimin e trashëgimisë kulturore tokësore dhe jotokësore për të siguruar që efektshmëria e aktiviteteve për menaxhimin e trashëgimisë kulturore të vlerësohet dhe çdo çështje të zbulohet menjëherë, në pajtim me Planin për Sigurimin e Pajtueshmërisë (CAL00-PMT-601-Y-TTM-0005)
- duke siguruar që të gjitha incidentet mjedisore, social-ekonomike dhe mbi trashëgiminë kulturore të raportohen dhe të trajtohen me efektshmëri dhe të nxirren mësim në pajtim me
- Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (CAL00-PMT-601-Y-TTM-0006))
- duke siguruar se të gjitha punimet e KONTRAKTORIT për pastrimin dhe ndërtimin në tokë do të monitorohen nën mbikëqyrjen me kohë të plotë të Monitoruesve të Trashëgimisë Kulturore (MTK) të KONTRAKTORIT.

Përveç kërkesave të sipërpërmendura, KOMPANIA do të punësojë një Këshilltar për Trashëgiminë Kulturore (KTK), përgjegjës të cilin do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen me:

- promovimin e pajtueshmërisë me Planin e Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore
- menaxhimin e ekspertëve të tjerë të trashëgimisë kulturore (ETK) të caktuar nga KOMPANIA, nëse kërkohet
- garantimin që të gjitha licencat e kërkuara për punime arkeologjike të jenë marrë nga organet përkatëse të qeverisë
- administrimin e kontratave të ndryshme, hartimin e programit për lehtësimin dhe koordinimin e Projektit dhe të interesave të jashtëm
- së bashku me ETK, të koordinojë, planifikojë dhe zhvillojë fushëveprimin e punës dhe mbikëqyrjen e Kontraktorit Arkeologjik
- mbështetjen e Projektit për të siguruar raporte dhe/ose leje të përshtatshme të dokumentuara, që do të lejojnë Projektin të vazhdojë
- së bashku me ETK, të verifikojë rëndësinë e trashëgimisë kulturore të çdo gjetjeje të rastit (atribuimi duhet të negociohet nga Kompania dhe ASHA)
- dhe rekomandimit të veprimeve të duhura
- kryerjes së trajnimeve për trashëgiminë kulturore me ETK.

Kontraktori arkeologjik është organizata e kontraktuar nga KONTRAKTORI, që do të jetë përgjegjëse për:


- kryerjen e gërmimeve arkeologjike
- monitorimin e aktiviteteve për lëvizjen e tokës dhe aktiviteteve të tjera të ndërtimit, (duke përdorur një MTK të punësuar nga KONTRAKTORI)
- regjistrimin, studimin dhe raportimin e materialeve të gjetura gjatë fazave të para-ndërtimit e ndërtimit dhe paraqitjen e raporteve për to, me një shpeshësi për të cilën është rënë dakord me KOMPANINË.
- raportimin e Gjetjeve të Rastësishme ashtu siç bëhen, në pajtim me Procedurën e Projektit për Gjetjet e Rastësishme

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	12 nga 42

- bërjen e rekomandimeve nëpërmjet KTK dhe ETK te KOMPANIA, KONTRAKTORI dhe Autoritetet
- dhënien e udhëzimeve personelit tjetër të projektit në terren që t'i njohin dhe të veprojnë për çështjet e trashëgimisë kulturore
- mbajtjen e regjistrimeve të përditësuara të aktiviteteve të përditshme të monitorimit dhe të çdo raporti të veçantë të përgatitur.

Kontraktori Arkeologjik do të jetë një kompani e licencuar e miratuar për punë në Shqipëri nga Ministria e Kulturës (MeK) e Qeverisë Shqiptare dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA)².

² MeK është organizata qeveritare që mbikëqyr të gjitha aktivitetet e trashëgimisë kulturore dhe është përgjegjëse për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore. ASA është një organ që përgjigjet te MeK për miratimin e punës dhe lëshimin e licencave të gërmimeve. Kjo agjenci do të ketë rolin parësor në monitorimin e punimeve të trashëgimisë kulturore.

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	13 nga 42

2 Shmangia dhe lehtësimi i ndikimit tokësor

2.1 Studimet e para-ndërtimit dhe përshtatjet e projektimit

Është përgjegjësia e KOMPANISË që të ndërmarrë shumicën e studimeve të para-ndërtimit. Përpara ndërtimit KOMPANIA do të ndërmarrë një studim të hollësishëm të të gjitha vendndodhjeve të identifikuar në VNMS. Studimi do të përbëhet nga identifikimi dhe vlerësimi i mëtejshëm i vendndodhjeve (të renditura në Tabelën A1-1, Shtojca 1) për të siguruar që të mund të bëhet një përgjigje dhe lehtësim i përshtatshëm. Një listë e hollësishme e plotë e veprimeve që do të ndërmerren në secilin vend do të miratohet bashkë me MeK dhe ASHA. Si pjesë e këtij procesi, KOMPANIA do të regjistrojë gjendjen dhe integritetin strukturor të çdo vendi të identifikuar me komponentët mbitorësor, që ndodhen në afërsi (50m) të gjurmës së projektit përpara ndërtimit (AL0447). Kjo ka rëndësi të veçantë në zonat ku dëmi për shkak të ndotjes ose dridhjeve konsiderohet i mundshëm. KOMPANIA do t'ia komunikojë VENDNDODHJET në një format GIS, së bashku me rezultatet e studimeve dhe çdo veprim që kërkohet, KONTRAKTORIT, i cili do të sigurohet se i di këto vende dhe kushtet e karakteristikave të para-ndërtimit:


Një listë e përditësuar nga angazhimet e njohura aktuale, që detajon vendndodhjet, shtrirjet dhe studimet e gjendjes do t'i jepet KONTRAKTORIT përpara ndërtimit. KOMPANIA do të komunikojë se ku do të implementojë KONTRAKTORI masa lehtësimi parandaluese (të tilla si gardhe, shenjzime, kontrolli i pluhurit ose sigurimi i hyrjes së publikut në zona të caktuara).

Çdo ndryshim i rrugëkalimit ose kërkesat për tokë shtesë do të kërkojnë studime të reja para ndërtimit në pajtim me standardet e përcaktuara nga VNMS dhe do të ndërmerren nga KONTRAKTORI.

Burimet e trashëgimisë kulturore duhet të mbahen parasysh dhe të përfshihen në fazën e projektimit të çdo sipërmarrjeje që lidhet me Projektin, e cila mund të ndikojë mbi vendndodhjet. Duhet bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur burimet e njohura të trashëgimisë kulturore gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të Projektit (AL0449, AL0456 dhe AL0464). Kjo do të përfshijë, kur është e mundur, marrjen e masave për të përshtatur kalimin e korridorit të ndërtimit që të shmangët dëmtimi fizik i Monumenteve të caktuara të Natyrës (AL0142), megaliteve (AL0449), monumenteve dhe vendndodhjeve arkeologjike (AL0464) e vendeve me vlerë TKJ (AL0456). Për vendndodhjet TKJ, Projekti, kur është e mundur do t'i shmangë ato nëpërmjet ri-skicimit të Projektit për të garantuar ndikime të kufizuara mbi rrethinat dhe peizazhet e tyre (AL0456).

Shmangia është metoda e parapëlqyer për lehtësimin dhe do të mbahet parasysh së bashku me masat e identifikuar të lehtësimit të renditura në Kapitullin 8.20.3 të "VNMS Shqipëri, Pjesa 8 - Vlerësimi i Ndikimeve dhe Masat e Lehtësimit" (AL0449, AL0456, AL0464). Të gjitha ndryshimet e rrugëkalimit të korridorit të ndërtimit nga KONTRAKTORI do të kërkojnë miratimin nga KOMPANIA.

Kur nuk është e mundur të shmangen monumentet ose vendet me vlerë TKJ (d.m.th., ato që ndodhen në rripin e reduktuar të punës prej 28m të gjerë për ndërtimin e gazsjellësit), KOMPANIA do të konsiderojë zhvendosjen, zëvendësimin e kompensimin e tyre dhe ato do të diskutohen si opsione me palët përkatëse të interesit (AL0463) (shih edhe Strategjinë e Angazhimit me Palët e Interesit TAP-HSE-ST-0009).

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	14 nga 42

2.2 Monitorimi arkeologjik i ndërtimit

Programi i Monitorimit të Ndërtimit do të kërkojë që të gjitha punimet e ndërtimit të bëhen nën mbikëqyrjen gjatë gjithë kohës nga një MTK. MTK do të dokumentojë dhe do të raportojë rregullisht për aktivitetet e monitorimit të ndërtimit siç është rënë dakord me MeK. Këto raporte do t'i nënshtrohen rishikimit e miratimit nga KTK, ETK dhe MeK.

Çdo ndikim i vëzhguar mbi trashëgiminë kulturore do të raportohet nga MTK te Koordinatorin e Trashëgimisë Kulturore (KooTK) të KOMPANISË dhe autoriteti përgjegjës qeveritar, që mund ta ndalojë punën deri sa të bëhet inspektimi dhe të merren masa riparuese. Kjo kërkesë zbatohet për ndikimet mbi trashëgiminë kulturore në të gjitha zonat që mund të preken nga Projekti.

2.3 Procedura e Gjetjeve të Rastësishme


Gjetjet e Rastësishme përkufizohen si objekte, veçori ose vende të mundshme të trashëgimisë kulturore (a paleontologjike), që identifikohen jashtë një përnjohjeje zyrtare të vendit ose pas saj, normalisht si rezultat i menaxhimit të ndërtimit. Gjetjet e Rastësishme mund të bëhen nga çdo anëtar i Projektit, duke përfshirë arkeologët, punëtorët që punojnë në vendet që nuk janë trashëgimi kulturore dhe vizitorët.

2.3.1 Kuadri i pajtueshmërisë

Një Procedurë për Gjetjet e Rastësishme kërkohet nga ligji shqiptar, Legjislacioni i BE-së dhe KP-të e BERZH dhe IFC, përveç Regjistrin të Angazhimit të Projektit për Shqipërinë. Objektivi i procedurës është të identifikojë dhe të mbrojë vendndodhje, objekte dhe veçori të trashëgimisë kulturore të paregjistruara më parë, nga dëmtimi i shkaktuar prej Projektit. Procedura zbatohet për objekte, veçori ose vendndodhje të trashëgimisë kulturore të identifikuar si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit në një zonë. Procedura përfshin monitorimin e të gjitha aktiviteteve të ndërtimit që gjëmojnë tokën nga një arkeolog profesionist (MTK i caktuar nga KONTRAKTORI dhe miratuar nga KOMPANIA dhe MeK) dhe ndalimin e punës (nëpërmjet zbatimit të një protokollit për ndalimin e punës) në afërsi të çdo zbulimi të ri arkeologjik. Nëse zbulohet një Gjetje e Rastësishme gjatë ndërtimit, procedurat e shpëtimit duhen bërë siç janë përcaktuar nga standardet ndërkombëtare dhe kombëtare shqiptare, nëse nuk mund të zbatohen masa të tjera lehtësuese për të hequr, shmangur ose mbrojtur. Aktivitetet e ndërtimit në vendndodhjen e Gjetjeve të Rastësishme do të rifillojnë vetëm pas zbatimit të masave lehtësuese të miratuara nga qeveria (AL0458) të tilla si shpëtimi, heqja, shmangia ose mbrojtja. Vazhdimi i ndërtimit pas një shpëtimi të Gjetjes së Rastësishme duhet të fillojë vetëm pasi të ketë përfunduar gërmimi i shpëtimit.

Artefaktet individuale janë të rëndësishme si tregues të pranisë së vendndodhjeve të trashëgimisë kulturore pranë sipërfaqes ose nën sipërfaqe. Megjithatë, vlera parësore e shumicës së artefakteve të trashëgimisë kulturore kuptohet vetëm kur objektet janë pjesë e një vendndodhjeje të interpretueshme të trashëgimisë kulturore. Kjo procedurë i kushton vëmendje mbrojtjes së vetë vendndodhjeve të trashëgimisë kulturore dhe jo artefakteve individuale, sepse sepse artefaktet individuale mund të hiqen lehtë. Rëndësia e artefakteve do të negociohet nga Kompania dhe ASHA.

Vendimi nëse një Gjetje e Rastësishme është një burim i trashëgimisë kulturore që kërkon trajtim shtesë do të bëhet nga një MTK në këshillim me ETK dhe KooTK duke u bazuar në përvojën profesionale dhe trajnimin. Çdo anëtar i forcës së punës të KOMPANISË dhe KONTRAKTORIT ka

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	15 nga 42

përgjegjësini të njoftojë menjëherë MTK ose ETK a KooTK në rast se dyshon për një Gjetje të Rastësishme.

2.3.2 Procedura e Gjetjeve të Rastësishme


KOMPANIA, KONTRAKTORI dhe nënkontraktorët e tij duhet të përdorin Procedurën e mëposhtme për Gjetjet e Rastësishme dhe ta zbatojnë atë kudo ku hasen objekte, vendndodhje, struktura ose grupe strukturash të lëvizshme a të palëvizshme, që kanë rëndësi arkeologjike, paleontologjike, historike, arkitekturore, fetare, estetike ose rëndësi tjetër kulturore. Procedura e Gjetjeve të Rastësishme do të zbatohet në të gjitha frontet e ndërtimit për të gjitha aktivitetet e pastrimit dhe gërmimit të tokës (AL0458).

Hapi më i vështirë është të garantohet që të gjitha gjetjet e rastësishme të nxitin zbatimin e saktë të këtij procesi, pasi punëtorët e patrajnuar shpesh nuk janë në gjendje të bëjnë dallimin ndërmjet karakteristikave normale të mjedisit (gurëve etj.) dhe, për shembull, gjetjeve paleontologjike. Për ta ndihmuar këtë, KTK dhe ETK do të bëjnë trajnime për ta ndërgjegjësuar forcën punëtore dhe do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për të verifikuar nëse një gjetje ka ndonjë rëndësi nga këndvështrimi i trashëgimisë kulturore ose jo. Për të pakësuar kohën për të marrë reagimet, MTK dhe KooTK e do të bazohen në vendndodhje për të gjitha punimet afër vendeve ose zonave të njohura të trashëgimisë kulturore me potencial të lartë arkeologjik. Përveç kësaj, këto aktivitete ndërtimi do të mbikëqyren nga MTK (AL0458). Për më shumë informacion referoju Planit për Sigurimin e Pajtuësishmërisë për Çështjet Mjedisore dhe Sociale (CAL00-PMT-601-Y-TTM-0005), që përshkruan aktivitetet e monitorimit dhe të sigurisë së KOMPANISË. KONTRAKTORI është përgjegjës për të garantuar akses të sigurt për Monitoruesin e Trashëgimisë Kulturore, Këshilltarin e Trashëgimisë Kulturore, kontraktorët arkeologjikë KooTK, ETK dhe personelin e Ministrisë së Kulturës në zonat e punimeve gjatë gjithë kohës.

Çdo Gjetje e Rastësishme ose ndikim i vërejtur mbi trashëgiminë kulturore do të raportohet nga MTK te Mbikëqyrësi i KONTRAKTORIT për zonën e punimeve, ETK dhe/ose KTK dhe autoriteti përgjegjës qeveritar, që mund ta ndalojë punën deri sa të bëhet inspektimi dhe të merren masat e lehtësimit. Kjo kërkesë zbatohet për ndikimet mbi trashëgiminë kulturore në të gjitha zonat që mund të preken nga Projekti.

MTK do ta identifikojë dhe do ta verifikojë gjetjen, do të vlerësojë rëndësinë e saj, (atribuimi i rëndësisë do të negociohet nga Kompania dhe ASHA) dhe, në këshillim me Mbikëqyrësin e KONTRAKTORIT, KooTK dhe ETK e KOMPANISË, do të vendosë nëse do të pezullohet puna në kantier dhe/ose në zonat më të gjera përreth, apo do të hiqet gjetja (nëse është një objekt që mund të hiqet lehtë si, për shembull, një monedhë etj.) dhe të lejohet që puna të vazhdojë. Në rastin e një Gjetjeje të Rastësishme që është një vendndodhje ose nuk mund të hiqet, puna në afërsi (mimimuni në të gjitha zonat 50m larg nga zbulimi) duhet të ndërpritet dhe zona duhet të shenjzohet për shmangie nga KONTRAKTORI (ose çdo nënkontraktor) (AL0458).

Skenarët për trajtimin e vendndodhjes që do të merren parasysh përfshijnë ruajtjen në vend nëpërmjet devijimit të rrugëkalimit ose teknikat të specializuara të ndërtimit, si dhe gërmimet e shpëtimit përpara se të bëhen punime të tjera ndërtimi, nëse shmangia nuk është e mundur. Nëse nevojitet shpëtimi arkeologjik për një Gjetje të Rastësishme, KOMPANIA është përgjegjëse që të garantojë të bëhet shpëtimi në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe shqiptare me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare (AL0557, AL0459).

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	16 nga 42

Aktivitetet e ndërtimit në një Gjetje të Rastësishme do të rifillojnë vetëm pasi të kenë përfunduar gërmimet e shpëtimit dhe implementimi i masave dhe/ose punimeve të trajtimit të miratuara nga qeveria (AL0556, AL0459). Një përshkrim i hollësishëm i Procedurës së Gjetjeve të Rastësishme paraqitet më poshtë.

Nëse zbulohet një Gjetje e Rastësishme nga MTK ose punonjësit, do të kryhen aktivitetet e mëposhtme:


- Ndërprerja e punës në afërsi nga forca punonjëse e KONTRAKTORIT, duke përfshirë çdo nënkontraktor, nëpërmjet zbatimit të një protokollit për ndalimin e punës (AL0765), nga Mbikëqyrësi i KONTRAKTORIT në këshillim me MTK.
- Shenjëzimi i zonës me gardh plastike të kuqe shumë të dukshëm nga KONTRAKTORI për të shmangur të gjitha zonat të paktën 50m nga zbulimi i gjetjes së rastësishme (AL0461)
- Njoftimi i mbikëqyrësit të KONTRAKTORIT për zonën e punimeve dhe përfaqësuesit që do të informojnë ETK. Më pas ETK do të informojë KTK e KOMPANISË dhe me MTK do të njoftojë përfaqësuesin e trashëgimisë kulturore të qeverisë në ASHA.
- Identifikimi dhe vlerësimi i rëndësisë fillestare të gjetjes për sa i përket trashëgimisë kulturore nga MTK duke punuar me Kompaninë dhe ASHA-n. Bazuar mbi këtë vlerësim, ETK dhe KTK e KOMPANISË do të konsultohen e do të vendosin së bashku nëse aktivitetet e ndërtimit në afërsi duhen pezulluar ose mund të rifillojnë. Aktivitetet e ndërtimit do të lejohen të vazhdojnë nëse gjetja mund të hiqet lehtësisht, p.sh., një monedhë.
- Në vartësi të faktit nëse shmangia është e mundur ose jo, dy skenarët do të shqyrtohen nga KOMPANIA dhe vendimi do t'i përcillet KONTRAKTORIT:
 - Nëse shmangia është e mundur, gjetja duhet të ruhet në vend nëpërmjet devijimit të rrugëkalimit ose teknikave të specializuara të ndërtimit.
 - Nëse shmangia nuk është e mundur, KOMPANIA është përgjegjëse për implementimin e një shpëtimi arkeologjik në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe shqiptare, me mbikëqyrjen dhe përfshirjen e institucioneve përkatëse qeveritare (AL0459).

Kur puna të ketë përfunduar, aktivitetet e ndërtimit mund të vazhdojnë.

2.3.3 Raportimi i Gjetjeve të Rastësishme

Nëse do të zbulohet një Gjetje e Rastësishme nga MTK ose nga punonjësit e KONTRAKTORIT, një Raport i Gjetjes së Rastësishme, që do t'i paraqitet KTK, do të përgatitet në bashkëpunim me MTK dhe ETK, brenda 48 orëve nga zbulimi i gjetjes, në pajtim me kërkesat e MeK ose ASHA. Ky raport duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- data dhe ora e zbulimit
- vendi i zbulimit (koordinatat e GPS dhe referencat PK [tokësore]).
- përshkrimi i zbulimit
- rëndësia e zbulimit - atribuimi i rëndësisë do të negociohet nga Kompania dhe ASHA.
- pesha dhe përmasat e përiferarta, d.m.th., mundësia për ta lëvizur zbulimin
- koha e përlogaritur që nevojitet për të bërë gërmimin e zbulimit
- rekomandimi si të vijohet më tej

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	17 nga 42

- masat e përkohshme të mbrojtjes të implementuara.

Kur të përcaktohet veprimi i përshtatshëm që duhet ndërmarrë në lidhje me Gjetjen e Rastësishme, do të bëhet konsultim me autoritetin përkatës, ASHA. Këto veprime mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara me:

- zhvendosjen, nëse është e përshtatshme, të artefakteve
- mbrojtjen *in situ*
- kryerjen e gërmimeve të mëtejshme brenda largësisë së specifikuar të pikës së zbulimit të vendndodhjeve
- vendimin për të vazhduar me punimet e ndërtimit.

2.3.4 Dokumentimi i Gjetjeve të Rastësishme

Personelit të Trashëgimisë Kulturore të KOMPANISË, personelit që nuk është për Trashëgiminë Kulturore të KOMPANISË dhe KONTRAKTORIT do t'i duhet të mbajnë regjistra të monitorimit, të Gjetjeve të Rastësishme dhe të masave të reagimit të ndërmarra për Gjetjet e Rastësishme. Për KONTRAKTORIN këto do të përfshijnë:


- dokumentimin e monitorimit të përditshëm që tregon zonat dhe aktivitetet e monitoruara; Gjetjet e Rastësishme të raportuara dhe rezultatet e çdo vlerësimi. Po ashtu, do të përfshihen komunikimet dhe udhëzimet (të tilla si ndalimi i punës dhe rifillimi i punës)
- raporte të përjavshme që përmbledhin aktivitetet e periudhës së raportimit, duke përfshirë Gjetjet e Rastësishme, vlerësimet dhe përcaktimet, komunikimet dhe udhëzimet e brendshme e të jashtme dhe dokumentacionin fotografik mbështetës (ose materiale të tjera reference sipas mundësisë). Gjithashtu, pritet edhe një raport shtesë që synon të përmbushë çdo kërkesë specifike të KTK, ETK dhe MeK.
- raporte mujore që përmbledhin rezultatet e monitorimit dhe të vlerësimit, gjendjen e masave të kërkuara për trajtimin e çdo vendndodhjeje, udhëzimet për KONTRAKTORIN dhe komunikime të tjera të brendshme dhe të jashtme.

2.3.5 Gjetjet që kërkojnë njoftimin e Autoriteteve Civile

Nuk është e pazakontë që, gjatë punimeve për lëvizjen e dheut, të zbulohen dëshmi të aktiviteteve të ndryshme njerëzore. Në shumicën e rasteve, mund të shihet se këto kanë një origjinë bindëse historike ose të mëhershme dhe nuk përfaqësojnë asnjë kërcënim ose interes për mirëqenien e shoqërisë bashkëkohore. Gjithsesi, ka disa lloje zbulimesh që janë me interes dhe duhet të raportohen tek Autoritet Civile. Këto mund të përfshijnë:

- varrime të njerëzve
- municione dhe eksplozivë të pashpërthyer (MPSH)
- vende për groposjen e kafshëve të sëmura.

Dy të fundit kanë procedurat e tyre të reagimit brenda kërkesave të Shëndetit dhe Sigurisë, por është krejtësisht e mundur që përfaqësuesit e ekipit të trashëgimisë kulturore të bëjnë zbulimet fillestare dhe ata duhet të jenë të vetëdijshëm për procedurat e sakta mbi zbulimin. Një pjesë e trajnimit të tyre do të përfshijë veprimet e para që duhen ndërmarrë në rast të zbulimeve të tilla. Për informacion të

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	18 nga 42

mëtejshëm, shikoni Pjesën 5.5.2 në Planin e Menaxhimit të Trajnimit (ESMP (CAL00-PMT-601-Y-TTM-0006)).

Eshtrat njerëzore janë një rast i ndryshëm, pasi vendvarrimet historike të njerëzve mund të ngatërrohen me vendvarrime të pashënuara të kohëve të fundit. Në raste të tilla, veprimi i duhur është që vendi të lihet i patrazuar dhe i mbrojtur e të raportohet tek Autoritetet Civile, që të hetohet prej tyre. Kur ekipi i trashëgimisë kulturore është i bindur për origjinën e lashtë të këtyre eshtrave, është kërkesë ligjore që zbulime të tilla dhe vlerësimi profesional për moshën e tyre të raportohen tek autoriteti vendor.

2.4 Mbrojtja e vendndodhjeve të njohura të trashëgimisë kulturore

2.4.1 Masat e përgjithshme të mbrojtjes

Vendndodhjet e njohura të trashëgimisë kulturore duhet të mbrohen nga dëmtimi që ka lidhje me Projektin. Kjo përfshin vendndodhjet e identifikuara përpara aktiviteteve të ndërtimit dhe ato të gjetura gjatë ndërtimit (Gjetjet e Rastësishme). Vendet mund të ndodhen në zonat e Projektit ose ngjitur me to.

Informacioni për vendndodhjen do të jepet nga KTK dhe ETK të KOMPANIA dhe personeli i KONTRAKTORIT me shkrim dhe verbalisht nëpërmjet dërgimit të dokumenteve zyrtare të përditësuara, në mbledhje e takime të përditshme për sigurinë, si të jetë e përshtatshme, për të garantuar që vendndodhjet e njohura të trashëgimisë kulturore të mbrohen sipas angazhimeve të përcaktuara për trashëgiminë kulturore.

Për vendndodhjet arkeologjike, KOMPANIA do të angazhojë autoritetet përkatëse shqiptare për vlerësimin e mëtejshëm të vendndodhjeve dhe përdorimin e metodave ndërhyrëse dhe jondërhyrëse (AL0462).


2.4.2 Mbrojtja nga dridhjet

Dëmtimi strukturor nga dridhjet mund të përkeqësojë integritetin strukturor tashmë të pakësuar të ndërtesave të vjetra dhe historike. Nëse ndonjë vlerësim strukturor i kërkuar nga autoritetet që do të ndërmerret nga KOMPANIA tregon se një vend është në rrezik nga ndikimet prej dridhjeve, KONTRAKTORI do të garantojë që të merren masat e duhura për të shmangur ose, kur nuk është e mundur, për të minimizuar çdo dëmtim të mundshëm që mund të ndodhë për shkak të aktiviteteve që kanë lidhje me Projektin (shih Shtojcën 1).

Në rastet kur një pjesë ose i gjithë vendi i trashëgimisë kulturore dëmtohet për shkak të dridhjeve të tepruara, KONTRAKTORI do të thërrasë menjëherë restauruesit për të riparuar strukturën me teknikat tradicionale të restaurimit (AL0440), pas miratimit nga KOMPANIA. Pas përfundimit, KOMPANIA do të përcaktojë nëse riparimet janë të mjaftueshme, dhe nëse nuk janë, mund të kërkojë masa të mëtejshme riparimi që të sigurohen nga KONTRAKTORI. Gjendja dhe integriteti strukturor i objekteve mbitorësore do të monitorohen periodikisht gjatë ndërtimit nga KONTRAKTORI për shenja përkeqësimi të shkaktuara nga dridhjet.

2.4.3 Mbrojtja nga pluhuri dhe format e tjera të ndotjes së gurëve

Disa forma të ndotjes mund të jenë të dëmshme për arkitekturën e gurtë. Nëse një vlerësim strukturor i ndërmarrë me kërkesën e autoriteteve tregon një rrezik të ndikimit nga ndotja, KONTRAKTORI me mbështetjen nga MTK do ta mbulojë ose përndryshe do ta mbrojë vendin nga impaktet e mundshme

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	19 nga 42

(AL0448) duke përdorur materialet e duhura. Nëse problemi është pluhuri që krijohet nga gërmimet e tokës, KOMPANIA me KONTRAKTORIN do të sigurojnë që të merren masat e duhura për ta shmangur ose, kur nuk është e mundur, për ta minimizuar çdo dëmtim të mundshëm që mund të ndodhë për shkak të aktiviteteve që kanë lidhje me Projektin.

Në çdo rast atje ku një vendndodhje me vlerë kulturore dëmtohet për shkak të ndotjes që ka lidhje me Projektin, vendndodhja do të pastrohet nga restaurues profesionistë (të caktuar nga KONTRAKTORI) dhe do të mbrohet nga dëmtimi i mëtejshëm (AL0448). Pas përfundimit, KOMPANIA do të përcaktojë nëse pastrimi është i mjaftueshëm dhe, nëse nuk është, mund të kërkojë masa të mëtejshme që të ndërmerren nga KONTRAKTORI. Gjendja dhe integriteti strukturor i objekteve mbitokësore do të monitorohen periodikisht gjatë ndërtimit nga KONTRAKTORI për shenja degradimi të shkaktuara nga ndotja (kryesisht në formën e pluhurit dhe të blözës).

2.4.4 Mbrojtja nga ndikimet negative estetike


Projekti do të hartohet që të lehtësojë ndikimet negative estetike e dëgjimore të pajisjeve. Nga KOMPANIA do të mbahen parasysh teknikat e mëposhtme estetike për implementim nga KONTRAKTORI (AL0451):

- pengesa për pakësimin e zhurmës
- ndërtime me profil të ulët
- planimetria dhe vendosja për të rritur në maksimum shfrytëzimin e topografisë dhe të bimësisë
- mbulimi
- përzierja me format topografike dhe modelet ekzistuese të bimësisë
- përdorimi i ngjyimit të mjedisit ose i teknikave të përparuara të kamuflazhit për të kufizuar ndikimet pamore.

2.4.5 Përdorimi nga komuniteti i vendeve të trashëgimisë kulturore

Kërkesat që kanë të bëjnë me përdorimin nga komuniteti të vendeve të trashëgimisë kulturore janë kryesisht përgjegjësia e KONTRAKTORIT. Për më shumë informacion, shih PKK e Trashëgimisë Kulturore Tokësore (AAL00-PMT-601-Y-TTM-0001). Përpara ndërtimit, KONTRAKTORI do të konsultojë përdoruesit e vendndodhjes nëpërmjet Punonjësit Ndërlidhës me Komunitetin (PNK) për të kuptuar përdorimin e vendndodhjes dhe si mund të ndikojë Projekti në aksesin e përdoruesve (AL0441). Konsultimi me përdoruesit e vendndodhjes do të bëhet nëpërmjet PNK për të kuptuar përdorimin e vendndodhjes, kufijtë e vendndodhjes dhe oraret e aktiviteteve fetare e kulturore, që mund të bien ndesh me aktivitetet e ndërtimit, operacionit dhe heqjes nga përdorimi (AL0454, AL0455). Për informacion të mëtejshëm mbi procedurat e angazhimit të palëve të interesit, shih Strategjinë e Angazhimit me Palët e Interesit (TAP-HSE-ST-0009) dhe PKK e Angazhimit Tokësor të Palëve të Interesit dhe Përgjegjësinë Sociale të Korporatës (TAP-ASM-PR-0001).

Në rast se aksesin në një vendndodhje të rëndësishme të trashëgimisë kulturore kufizohet ose bllokohet, KONTRAKTORI do të sigurojë akses alternativ duke shfrytëzuar informacionin e dhënë nga palët e interesit dhe duke njoftuar publikun për bllokimin dhe mënyrat alternative të aksesit (AL0439). Ndërprerja e aksesit të përdoruesve, veçanërisht në monumente e vendndodhje të rëndësishme me vlerë TKJ, ka të ngjarë të shkaktojë probleme në komunitet dhe prandaj, kur është e përshtatshme,

 Trans Adriatic Pipeline	TAP AG Dokumenti nr.:	AAL00-PMT-601-Y-TTM- 0017	Nr. i rish.:	2
Emblema e kontraktorit	Dok. Titulli:	Plani i TAP Shqipëri për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore	Faqja:	20 nga 42

KONTRAKTORI do të sigurojë që pajisjet dhe aktivitetet e Projektit të planifikohen dhe të vendosen për të shmangur kufizimin e aksesit të vendndodhja (AL0443).

3 Shmangia dhe lehtësimi i ndikimit jotokësor

3.1 Studimet e para-ndërtimit dhe përshtatjet e projektimit

3.1.1 Studimet bregdetare të para-ndërtimit dhe përshtatjet e projektimit

Në përputhje me përgjegjësitë e veta, KOMPANIA ka ndërmarrë studime të para-ndërtimit përpara se të fillonte ndërtimi, me qëllim regjistrimin e çdo trashëgimie kulturore me rëndësi të paidentifikuar më parë përgjatë rrugëkalimit bregdetar të gazsjellësit (Raporti mbi Studimin Arkeologjik Detar AAL00-ERM-641-Y-TAE-1022). Studimet nuk identifikuan asnjë vendndodhje të trashëgimisë kulturore.

Ky informacioni do t'i komunikohet KONTRAKTORIT përpara fillimit të ndërtimit dhe pasi t'u jetë parashtruar autoriteteve përkatëse shqiptare.

Të gjitha devijimet e rrugëkalimeve të korridorit të ndërtimit nga KONTRAKTORI do të kërkojnë miratimin nga KOMPANIA dhe inspektime shtesë para ndërtimit.

